

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Kryeinspektor

16 Janar, 2024

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Regjistrimet në kopshtin e fëmijëve për vitin shkollor 2024-2025 tashmë janë hapur. **Nëse keni një fëmijë që do të jetë pesë vjeç në ose para 1 Shtatorit 2024, ju lutemi regjistrojeni deri më 31 Maj për t'i dhënë një mundësi në "Thrive at Five."**

Ka tre mënyra për t'u regjistruar:

- Online duke përdorur këtë : "[online registration portal](#)" / [portal regjistrimi online](#)
- Personalisht në shkollën tuaj të zonës (lagjes).
- Personalisht në: School District of Philadelphia Office of Student Enrollment & Placement – 440 N. Broad St.. | 1st Floor, Suite 111

Ka vende të kufizuara në shkolla, kështu që është e rëndësishme të veproni shpejt. Pasi të plotësohen vendet, asnjë nxënës i ri nuk mund të regjistrohet në atë shkollë. Regjistrimi i hershëm gjithashtu u jep familjeve dhe fëmijëve kohë për t'u takuar me personelin e shkollës dhe për t'u njohur me shkollën, gjë që ndihmon në lehtësimin e tranzicionit në kopshtin e fëmijëve. Shkollat e drejtorisë do të mbajnë dy "Kindergarten Open Houses": e para është planifikuar në 5 Mars, ndërsa e dyta do të zhvillohet gjatë javës së 13 Majit. Ju lutem kontrolloni në [philasd.org/thriveatfive](#) për kohën dhe vendndodhjen e saktë.

Drejtorja ka gjithashtu një program të plotë ditor të Para-Kopshtit, me rreth 175 vende për para-Kopshtin në të gjithë qytetin për t'u shërbyer nxënësve tanë më të vegjël. Ky program ofron një kurrikulë cilësore, mbështetje për nevoja të veçanta dhe mundësi për pjesëmarrjen e prindërve. Për të mësuar më shumë dhe për t'u regjistruar, vizitoni në [philasd.org/prek](#).

Studimet tregojnë se fëmijët që ndjekin para-kopshtin dhe kopshtin e fëmijëve ndërtojnë besim, fitojnë aftësi të forta social-emocionale dhe kanë më shumë mundësi të lexojnë në nivelin e klasës deri në fund të kopshtit - *të gjitha këto vendosin një bazë të fortë për suksesin e tyre afatgjatë akademik.*

Ne të gjithë luajmë një rol për të ndihmuar fëmijët e Filadelfias të përparojnë. Ndaj ju lutem mos vononi. Regjistroni fëmijën tuaj në Kopshtin e Fëmijëve dhe Para-Kopshtin sot!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Kryeinspektor

Drejtorja Arsimore e Filadelfias

Translation and Interpretation Center
(1/2024)

AMFS_ Kindergarten Registration. JANUARY 2024
(Albanian)